



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.39/2025

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi kryesues, Hajriz Hoti dhe Kujtim Pasuli anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të bërjes së fushatës zgjedhore duke shfrytëzuar hapësirat publike, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 17.01.2025, merr këtë:

#### V E N D I M

**Hidhet i palejuar ankesa A.nr.39/2025** i datës 15.01.2025, e paraqitur nga Institutit Demokratik i Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025.

#### A r s y e t i m

Me datë 15.01.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Institutit Demokratit i Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se më 13.01.2025, rreth orës 15:00, subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës ka zhvilluar një takim në kuadër të fushatës zgjedhore me stafin shëndetësor në komunën e Vitisë.

Më tutje parashtruesi i ankesës thekson se nga njoftimi i publikuar në rrjetin social facebook nga subjekti politik z.Lumir Abdigjiku vërehet qartë që subjekti në fjalë pra LDK ka shfrytëzuar hapësirat publike, konkretisht objektin e QKMF-Nëna Terezë në qytetin e Vitisë, duke takuar stafin shëndetësor të spitalit publik në komunën e Vitisë, brenda orarit të punës. Sipas parashtruesit të ankesës një veprim i tillë i Lidhjes Demokratike të Kosovës përbën shkelje ligjore, të nenit 36 paragrafi 1, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, për më tepër subjekti

politik LDK me këtë veprim ka cënuar edhe paragrafin 2 të nenit 36 të këtij Ligji për faktin se gjatë këtij takimi përdori pozitën publike të stafit shëndetësor për të zhvilluar fushatë zgjedhore.

Paneli pasi qe shqyrtoj lejueshmërinë e apelit gjeti se:

### **Ankesa është e palejuar**

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se ankesa e parashtruar nga Instituti Demokratik i Kosovë (KDI), ka njëjtësi objektive, gjendje të njëjtë faktike me ankesën e parashtruar nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) Anr.35/2025 të datës 14.01.2025, kundër Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), e cila çështje është vendosur me vendimin e PZAP-it, Anr. 35/2025 të datës 16.01.2025 me të cilin Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), i është shqiptuar dënimi me gjobë në lartësi prej 8,000.00( tetë mijë) euro.

Meqenëse për rastin në fjalë është vendosur me vendimin e PZAP-it, Anr. 35/2025 të datës 16.01.2025, dhe pasi që për të njëjtën çështje është vendosur në vendimin e lartcekur paneli nuk u lëshua fare në shqyrtim të kësaj çështje të theksuar në ankesë.

Prandaj, nisur nga të gjitha arsyet e paraqitura lart, në pajtim me nenin 119 paragrafi 3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, lidhur me nenin 13 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Rregullores së PZAP-it Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, duke i hedhur poshtë ankesën si të pa lejuar.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 39/2025 më datën 17.01.2025



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.